



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 05.12.2024

Nr: 42

Ora: 12:00

ANULLIM VENDIMI

PËR

MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 14, DATË 24.10.2024
TË DEPOZITUAR NGA TV KOPLIKU

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.12.2024, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi kryesisht çështjen me:

ANKUES: TV Kopliku

OBJEKT: *Pa objekt*

BAZË LIGJORE: Nenet 109 shkronja “b”, 113 dhe 114 pika 1 të K.Pr.Administrative

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 05.12.2024 Nr: 42
Ora: 12:00



“Anullim vendimi për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 14 datë 24.10.2024 të depozituar nga TV Kopliku”

VËREN:

1. Subjekti TV Kopliku depozitoi pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, u regjistrua në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 14 regj., datë 24.10.2024.
2. KAS-i caktoi me short anëtarin z. Ledio Braho si relator dhe vendosi zhvillimin e seancës paraprake në datën 19.11.2024, ora 11:00. Në seancë ishin të pranishëm anëtarët e KAS-it dhe administrata e KQZ-së.
3. Në përfundim KAS-i, me vendimin nr. 34, datë 19.11.2024 vendosi mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 14, datë 24.10.2024, të depozituar nga TV Kopliku.

KAS-i konstaton:

4. Në arsyetimin e vendimit nr. 34, datë 19.11.2024, në lidhje me mospranimin e kërkesës ankimore nr. 14, datë 24.10.2024, të depozituar nga TV Kopliku, KAS është shprehur se:

“Vendimi nr. 186, datë 09.10.2024 shpreh vetëm vullnetin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të vënë në lëvizje KAS-in me kërkesën për marrjen e masës administrative me gjobë. Ky vendim nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe nuk çënon asnjë interes të palëve të prekura, sepse kompetenca për vendosje sanksioni administrativ është kompetencë e KAS-it.

Të drejtat e palëve të prekura, në rastet e procedimit me kërkesë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbrohen vetëm duke marrë pjesë si palë në shqyrtimin administrativ që zhvillohet nga KAS-i, dhe jo me procedurë ankimore ndaj vendimit përmbyllës të Komisionerit”.

5. Duke qenë se vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 186, datë 08.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023” në dispozitivin e tij, nga pika 2 deri në pikën 88 përmban propozime për KAS në zbatim të nenit 21, pika 1, shkronja “dh”, të K.Zgjedhor dhe nga pika 89 deri në pikën 104 përmban sanksione administrative me gjobë të vendosura nga KShZ, KAS, në vendimin nr. 34, datë 19.11.2024, e ka trajtuar kërkesën ankimore të depozituar nga TV Kopliku si një ndër rastet që sanksioni administrativ ishte propozuar nga KShZ, ndërkohë që në fakt për këtë subjekt KShZ ka vendosur sanksion administrativ dhe për rrjedhojë TV Kopliku legjitimohet t’i drejtohet me ankim KAS, si i vetmi mjet procedural për të kundërshtuar vendimmarrjen e KShZ.
6. Gjendur në situatën si më sipër cituar, në lidhje me aktin administrativ vendim nr. 34, datë 19.11.2024 të KAS, do i referohemi nenit 109 shkronja “b” të K.Pr.Administrative që parashikon se “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”. Referuar kësaj dispozite, mospranimi për shqyrtim i kërkesës ankimore me arsyetimin e sipërcituar se KAS nuk ka kompetencë për shqyrtimin e kërkesës ankimore, është një akt administrativ i paligjshëm për shkak se është shkelur nenet 124/1 dhe 130 të K.Zgjedhor në lidhje me të drejtën e ankimit.



7. Në lidhje me procedurën dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit të aktit administrativ, neni 113 i K.Pr.Administrative parashikon se:

“1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.

2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.

3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë”.

8. Ndërkohë që në lidhje me anulimin dhe shfuqizimin diskrecionar të një akti administrativ të paligjshëm neni 114 pika 1 i K.Pr.Administrative parashikon se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108, të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë”.*

9. Sa referuar më sipër, KAS kryesisht konstatoi paligjshmërinë e aktit administrativ vendim nr. 34, datë 19.11.2024 të KAS,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 109, shkronja “b”, 113 dhe 114, pika 1 të K.Pr.Administrative, KAS-i

V E N D O S I:

1. Anulimin e vendimit nr. 34, datë 19.11.2024 *“Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 14 datë 24.10.2024 të depozituar nga TV Kopliku”.*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1, të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 05.12.2024.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar